

IDENTIFIKIMI I DOKUMENTIT

SHA “M-NAV” SHKUP

Program për të ofruar shërbime të fluturimeve ajrore për vitin 2021

Nëntor 2020

Përshkrimi i dokumentit: Program për të ofruar shërbime të fluturimeve ajrore në SHA “M-NAV” Shkup, për vitin 2021, në të cilin përcaktohen vizioni, misioni, qëllimet strategjike dhe operative të shoqërisë për vitin 2021, bashkëpunimi rajonal dhe projektet e zhvillimit të shoqërisë, qëllimet strategjike dhe aktivitetet e Sektorit të fluturimit ajror, Sektorit të teknikës së fluturimit ajror dhe Sektorit të çështjeve financiare, të çështjeve juridike, të zhvillimit dhe

të investimeve për vitin 2021.

Njëkohësisht, në shtojcën 1 është bashkëngjitur Plani financiar i punës së SHA “M-NAV” Shkup për vitin 2021.

Titulli

**SHA “M-NAV” SHKUP
PROGRAM PËR TË OFRUAR SHËRBIME TË FLUTURIMIT AJROR PËR VITIN 2021**

Numri referues: MNV-610-201-03	Numri i botimit: 1.0
	Data: 27/11/2020

Ekstrakt:

Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut SHA “M-NAV” Shkup, gjithë veprimtarinë e tij e fokuson drejt ofrimit të sigurt, të rregullt dhe efikas të shërbimeve të fluturimit ajror, përndryshe duke siguruar kushtet në nivelin e nevojshëm të sigurisë dhe të sigurimit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare....”

Fjalët kyç:

Qëllimet strategjike, qëllimet operative, vëllimi i trafikut, kontrolli i fluturimeve, navigacioni i fluturimit ajror, standardet e sigurisë, teknika e fluturimit ajror

Statusi i dokumentit:	Versioni i punës	<input type="checkbox"/>	Klasifikimi:	Dokumenti i brendshëm	<input type="checkbox"/>
	Versioni i saktë	<input checked="" type="checkbox"/>		Dokumenti publik	<input checked="" type="checkbox"/>
	Botimi i shpallur	<input type="checkbox"/>		I besueshëm	<input type="checkbox"/>

Lokacioni:	Shkup
-------------------	--------------

PRANIMI I DOKUMENTIT

Në tabelën vijuese janë paraqitur autorët dhe personat të cilët e kanë përpunuar/miratuar këtë dokument.

Funksioni	Emri, mbiemri dhe nënshkrimi	Data
------------------	-------------------------------------	-------------

Përpunoi:	FilipTrandafilovski Këshilltar i pavarur i Njesisë së planifikimit, të zhvillimit dhe të huamarrjes ndërkombëtare	
Kontrolloi Aspekti - cilësia	Leonora Shala Shefe e Seksionit të cilësisë - Sigurisë në Njësinë e sigurisë, të sigurimit dhe të cilësisë	
Me pajtim të	Olivera Micevska Udhëheqëse e Njesisë së planifikimit, të zhvillimit dhe të huamarrjes ndërkombëtare	
Miratoi	Fahrudin Hamidi Kryetar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Fluturimit ajror Vladko Krstevski Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Teknikës së fluturimit ajror Migjen Salmani Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Çështjeve financiare, i çështjeve juridike, i zhvillimit dhe i investimeve	

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1.1 Organizimi i Sektorit nacional të fluturimit ajror	Error! Bookmark not defined.
1.2 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.....	Error! Bookmark not defined.
1.3 SHA “M-NAV” Shkup - Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror	Error! Bookmark not defined.
1.4 Misioni	Error! Bookmark not defined.
1.5 Vizioni.....	Error! Bookmark not defined.
1.6 Qëllimet strategjike	Error! Bookmark not defined.
1.7 Qëllimet operative.....	Error! Bookmark not defined.
1.8 Vlerat	Error! Bookmark not defined.
1.9 Financimi	Error! Bookmark not defined.
1.10 Siguria	Error! Bookmark not defined.
1.11 Dokumenti LSSIP	11
1.12 Bashkëpunimi rajonal.....	Error! Bookmark not defined.
1.13 Përmirësimi i strukturës së hapësirës ajrore, pas hapjes së hapësirës ajrore të Kosovës	Error! Bookmark not defined.
2. SEKTORI I FLUTURIMIT AJROR	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
2.1. Qëllimet strategjike të CBH-së	Error! Bookmark not defined.
2.2. Aktivitete për realizimin e qëllimeve të përcaktuara të CBH-së	Error! Bookmark not defined.
3. SEKTORI I TEKNIKËS SË FLUTURIMIT AJROR	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1 Qëllimet strategjike të CBT-së.....	Error! Bookmark not defined.
3.2 Aktivitete për realizimin e qëllimeve të përcaktuara të CBT-së	Error! Bookmark not defined.
4. SEKTORI I ÇËSHTJEVE FINANCIARE, I ÇËSHTJEVE JURIDIKE, I ZHVILLIMIT DHE I INVESTIMEVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.1 Qëllimet e Sektorit të ÇFÇJZHI	Error! Bookmark not defined.
5. NJËSIA E SIGURISË, E SIGURIMIT DHE E CILËSISË	76
6. NJËSIA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM	79
7.TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI - KEY PERFORMANCE INDICATORS) ...	80

1. HYRJE

Rëndësia e transportit ajror për rritjen ekonomike dhe prosperitetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut vetëm rritet. Përmirësimet në transportin ajror në përgjithësi, por edhe përmirësimet në shërbimet e të fluturimit ajror si një nga segmentet më të rëndësishme të tij, do të mundësojnë rritjen e industrisë dhe zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare, dhe njerëzit do të jenë në gjendje të udhëtojnë më lehtë në dhe nga shteti.

Përveç kësaj, sistemi modern dhe i sigurt i fluturimit ajror do të ndihmojë Republikën e Maqedonisë së Veriut të arrijë qëllimet e saja për integrimin në Bashkimin Europian nëpërmjet shfrytëzimit të vetë sistemit, si dhe efekteve të rritjes pozitive që mund të rezultojë nga rritja e transportit ajror.

Nëpërmjet zhvillimit të sistemit të fluturimit ajror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të arrihej një nga qëllimet më të rëndësishme strategjike dhe ai është integrimi në sistemin e Qiellit të Vetëm Europian (Single European Sky) dhe natyrisht, harmonizimi me legjislacionin europian dhe standardet e organizatave përkatëse europiane të fluturimit ajror ndërkombëtar.

Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut SHA "M-NAV" Shkup, gjithë veprimtarinë e tij e fokuson drejt ofrimit të sigurt, të rregullt dhe efikas të shërbimeve të fluturimit ajror, përndryshe ofron shërbime në nivelin e kërkuar të sigurisë dhe të sigurimit në përputhje me standardet e brendshme dhe ndërkombëtare, bën përpjekje për të siguruar shpenzime efikase – (costefficientservis) dhe zvogëlim të vazhdueshëm të shpenzimeve të shërbimit, zbatimi i rrugëve ajrore sa më të shkurtra të mundshme duke u kujdesur për mjedisin jetësor etj.

1.1 Organizimi i Sektorit kombëtar i fluturimit ajror

Organizimi aktual i Sektorit kombëtar të fluturimit ajror ka strukturën institucionale të mëposhtme:

1.1.1. **Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve (MTL)** – kompetente për punët e fushës së fluturimit ajror:

- përgatit strategjinë nacionale për zhvillimin e fluturimit ajror si një dokument operativ;
- realizon politikën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e fluturimit ajror;
- zbaton politikën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në dhënien e koncesioneve në fushën e fluturimit ajror;
- propozon ligje në fushën e fluturimit ajror, përgatit dhe miraton aktet nënligjore të parashikuara nga ky ligj;
- përgatit dhe miraton aktet nënligjore që përshkruajnë masat, mënyrën dhe kushtet për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të BE-së, praktikave dhe normat e rekomanduara në fushën e realizimit të mbikëqyrjes inspektuese të fluturimit ajror;
- zbaton një procedurë për vendosjen e përkohshme të një koncesioni nën udhëheqjen e përkohshme të administratës së detyrueshme (sekuestrimi);
- kryen punë të tjera të përcaktuara me rregullat e fushës së aviacionit.

1.1.2. **Agjencia e Fluturimit Ajror Civil (AAC)** - organ i pavarur rregullator me kompetenca publike të përcaktuara me ligj. Agjencia në punën e saj dhe në sjelljen e vendimeve brenda kompetencave të saja është plotësisht e pavarur politikisht, financiarisht dhe funksionalisht nga një organ tjetër shtetëror, një person tjetër publik juridik ose shoqëri

tregtare që realizon veprimtarinë në fushën e fluturimit ajror dhe është e paanshme ndaj tyre.

- 1.1.3. **Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror - SHA "M-NAV" Shkup** -shoqëri aksionare në pronësi shtetërore, e projektuar dhe certifikuar për të dhënë shërbime të fluturimit ajror mbi një bazë ekskluzive në hapësirën ajrore maqedonase, nëpërmjet të cilës sigurimi i shërbimeve të saj realizohet në përputhje me standardet dhe rregullat ndërkombëtare të fluturimit ajror.
- 1.1.4. **SHPKNJP "TAV" Maqedoni** - menaxhon dhe operon në aeroportet e vendit. "TAV" siguron operacione të integruara të aeroporteve në të dy aeroportet e vendit, duke përfshirë shërbimin në tokë, shërbimet e pasagjerëve, parkingjet e veturave, ushqimin, pijet dhe shërbimet administrative terminale.
- 1.1.5. **Komiteti i Hetimit të Aksidenteve të Fluturimit Ajror dhe i Incidenteve të Rënda** - i formuar me Vendimin nr. 41-806/1 datë 3.4.2012, të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 49/12 dhe 73/18) si trup i pavarur hetimor me kapacitetin e një personi juridik që heton aksidentet që përfshijnë avionët civilë ose parashutat.
- 1.1.6. **Komiteti Civil Ushtarak**- i formuar me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë më datë 30.7.2011, në bazë të nenit 58, paragrafi (2) të Ligjit të Aviacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103 / 08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19) dhe neni 36, paragrafi (6) i Ligjit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/2010), me qëllim që të kryejnë punë në lidhje me menaxhimin dhe shfrytëzimin fleksibël të hapësirës ajrore.

1.2 Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare

Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e organizatave ndërkombëtare në vijim, për të cilat kërkohet AFAC dhe SHA "M-NAV" Shkup, të punojnë sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara dhe përbushjes së detyrimeve specifike në lidhje me të gjitha aspektet e punës.

- Organizata Ndërkombëtare e Fluturimit Ajror Civil (ICAO) - Nga data 9.1.1993 Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e një agjencie të specializuar e Kombeve të Bashkuara, e themeluar në vitin 1944, e cila synon të nxisë bashkëpunimin midis kombeve në mënyrë që fluturimi ajror ndërkombëtar të zhvillohet në mënyrë të sigurt, të rregullt, efikase dhe trafiku ajror ndërkombëtar të vendoset në bazë të parimit të barazisë së të gjitha subjekteve që marrin pjesë në trafikun ajror.
- Konferenca Europiane e Fluturimit Ajror Civil (ECAC) - Nga data 3.7.1997 Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e një organizate ndërqeveritare e themeluar në vitin 1955 për të promovuar zhvillimin e vazhdueshëm të një sistemi të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm të trafikut ajror në Europë.
- Organizata Europiane e Sigurisë së Fluturimit Ajror (EUROCONTROL) - Nga data 1.11.1998 Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e themeluar në vitin 1960, misioni i së cilës është të harmonizojë dhe integrojë shërbimet e fluturimit ajror në Evropë, me qëllim që të krijojë një sistem të harmonizuar të menaxhimit të trafikut ajror për shfrytëzuesit civilë dhe ushtarakë, për të arritur qarkullim të sigurt, të mbrojtur, të rregullt, të shpejtë dhe ekonomik të trafikut në të gjithë Evropën, duke minimizuar ndikimin në rreth.
- Agjencia Europiane e Sigurisë së Fluturimit Ajror (EASA) - Nga data 3.12.2008 Republika e Maqedonisë së Veriut u bë anëtare e plotë e Pushteteve të Përbashkëta të Fluturimit Ajror

European (JAA), trup punues shoqërues i Konferencës Europiane të Fluturimit Ajror Civil (ECAC), i themeluar në vitin 1970 me qëllimin që të miratojë, zhvillojë dhe zbatojë procedura, kërkesa dhe standarde të unifikuara bashkërisht në fushën e sigurisë së fluturimeve ajrore. Më datë 30.6.2009 JAA pushoi së ekzistuari dhe funksionet e saj i merr përsipër Agjencia Europiane e Sigurisë së Fluturimit Ajror. Misioni i kësaj agjencie është t'i sigurojë asistencë teknike dhe profesionale Komisionit Europian duke përgatitur rregullore për sigurinë e fluturimit ajror në fusha të ndryshme, ndihmë teknike për lidhjen e marrëveshjeve të përbashkëta ndërkombëtare etj.

- Fusha e Përbashkët e Fluturimit Ajror Europian (FPFAE) - Ligji i Ratifikimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve të tij anëtare, Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Islandës, Republika e Malit të Zi, Mbretëria e Norvegjisë, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Përkohshëm të Kosovës për krijimin e Fushës së Përbashkët të Fluturimit Ajror Europian, i ratifikuar dhe i botuar në "Gazetën Zyrtare të RM-së" nr. 27/2007 dhe 98/2009, hyri në fuqi më 1 dhjetor 2017, që krijoi FPFAE-në për qasje të përbashkët në tregjet e trafikut ajror të palëve kontraktuese dhe lirinë e krijimit, me kushte të barabarta të konkurrencës dhe respektimin e rregullave të njëjta, përfshirë fushat e sigurisë, sigurimit, organizimit të trafikut ajror, harmonizimit social dhe mjedisit jetësor dhe nëpërmjet zbatimit të rregullave në një bazë shumëpalëshe brenda FPFAE-së .
- Danub FAB - Në vitin 2015 Republika e Maqedonisë së Veriut fitoi statusin e vëzhguesit në Danub FAB dhe kjo u konfirmua zyrtarisht në takimin e Këshillit Drejtues të Danub FAB në tetor të vitit 2015 në Sofje. Njëkohësisht, Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, në emër të Qeverisë së RMV-së kërkoi anëtarësimin e asociuar në BLUEMED FAB. E njëjta pritet të miratohet zyrtarisht në BLUEMED FAB Governing Council, në shkurt të vitit 2020.
- FAB BLUEMED – Në vitin 2020, Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve e Republikës së Maqedonisë së Veriut në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me shtetet e tjera anëtare të bllokut funksional të hapësirës ajrore BLUEMED FAB.
- NATO (North Atlantic Treaty Organisation) - Republika e Maqedonisë së Veriut më 27.3.2020 u bë anëtare e plotë e Aleancës së NATO-s.

1.3 SHA "M-NAV" Shkup – Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror

Në përputhje me nenin 60 të Ligjit të Aviacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42 / 14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), për kryerjen e shërbimeve të fluturimit ajror, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelon shoqëri aksionare me një aksionar, shteti - ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror, në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare. Mënyra e themelimit, veprimtaritë dhe mënyra e menaxhimit rregullohen me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë. Sipas gjendjes aktuale të lëshuar nga Regjistri Qendror, data e themelimit të SHA "M-NAV" Shkup është 4.11.2008.

Më 10 mars 2010 SHA "M-NAV" Shkup mori Vërtetim të aftësisë për ofrimin e shërbimeve të fluturimit ajror MK-01/2010ANSP, të vlefshëm për dy vjet dhe të lëshuar nga Agjencia e Fluturimit Ajror Civil.

Në përputhje me nenin 53, paragrafi (4) të Ligjit të Aviacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19 dhe 48/20 - Tekst përfundimtar) - "(4) për marrjen e Vërtetimit të aftësisë për të ofruar

shërbime navigacioni të fluturimit ajror, ofruesi i shërbimit duhet të ketë stafin e nevojshëm, pajisjet e nevojshme, si dhe t'i plotësojë kushte të tjera të veçanta e të nevojshme për funksionimin e sigurt dhe të rregullt."

Në përputhje me këtë nen dhe në lidhje me kushtet e përcaktuara në Rregulloren e ofrimit të shërbimeve të fluturimit ajror, si dhe kushtet e veçanta në lidhje me personelin e nevojshëm, pajisjet dhe kushtet e tjera të veçanta të nevojshme për funksionimin e sigurt dhe të rregullt ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 08/2018), në periudhën e kaluar dhe në vazhdim, Agjencia e Fluturimit Ajror Civil e Republikës së Maqedonisë së Veriut vërteton se SHA "M-NAV" Shkup, si ofrues i shërbimeve të fluturimit ajror, i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet e vlefshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve të fluturimit ajror dhe aftësinë për t'i pajisur ata me vërtetim, i cili është i vlefshëm për dy vjet. Në mars 2020, SHA "M-NAV" Shkup, nga Agjencia e Fluturimit Ajror Civil mori Aktvendim për vazhdimin e Vërtetimit për të ofruar shërbime të fluturimit ajror me numrin MK01-2020/ANSP.

Me Vendim për ndryshimin e statutit të Shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit të fluturimit ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 70/19) dhe me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë së ofruesit të shërbimeve të fluturimit ajror SHA "M-NAV" Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24/20), u ndryshua emri i shoqërisë, sipas të cilit shoqëria aksionare merr pjesë në qarkullime juridike nën kompaninë: Shoqëria aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë së ofruesit të shërbimeve të fluturimit ajror SHA "M-NAV" Shkup. Shkurtesa e emrit të kompanisë është: SHA "M-NAV"- Shkup. Emri i shoqërisë është i shkruar në gjuhën e folur nga të paktën 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj është: "Shoqëria Aksionare në Pronësi Shtetërore për Kryerjen e Veprimtarisë së Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionin Ajror "M-NAV" SHA Shkup". Shkurtesa e emrit të kompanisë në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj është: "M-NAV" SHA, Shkup. Në tregtinë e jashtme, emri i shoqërisë është "M-NAV" Air Navigation Service Provider of the Republic of North Macedonia", GOJSC.

Lënda e punës së ofruesit të shërbimeve të fluturimit ajror

Lëndët e punës së shoqërisë janë aktivitetet në vijim:

1. Ofrimi i shërbimeve të fluturimit ajror (ANS – Air Navigation Services) si një veprimtari parësore e shoqërisë, e cila përfshin:

1.1 Shërbimet e ATM (Air Traffic Management) si dhe:

a) Shërbimet ATS (ATS-Air Traffic Services):

- Kontrolli i Trafikut Ajror (ATC – Air Traffic Control), që u jepet avionëve duke lëshuar miratime dhe udhëzime për kontrollin kompetent të trafikut ajror për të mundësuar rrjedhën e sigurt, të rregullt dhe të shpejtë të trafikut ajror;
- Shërbimi i Informacionit të Fluturimit (FIS - Flight Information Service), i cili jepet duke lëshuar informacione të rëndësishme për zhvillimin e sigurt të trafikut ajror;
- Shërbimi i Alarmit (ALRT - Alerting Service) i cili sigurohet për një avion që ka nevojë për kërkim dhe shpëtim nëpërmjet njoftimit dhe koordinimit të subjekteve kompetente.

b) Menaxhimi i Qarkullimit të Trafikut Ajror (ATFM - Air Traffics Flow Management), që bëhet për të mundësuar shfrytëzimin maksimal të kapacitetit të kontrollit të trafikut ajror dhe vëllimit të trafikut;

c) Menaxhimi i Hapësirës Ajrore (ASM – Air Space Management), që bëhet për të siguruar shfrytëzimin maksimal dhe fleksibël të hapësirës ajrore për të gjithë shfrytëzuesit;

ç) Funkcionet e Rrjetit (Network functions) janë shërbime të cilat jepen për të siguruar aranzhime të hollësishme për vendime të përbashkëta midis shteteve anëtare, ofruesve të shërbimeve të fluturimit ajror dhe funksionit të udhëheqjes së rrjetit.

- 1.2. Shërbimi i Informacionit Aeronautik (Aeronautical Information Service) AIS, i cili përfshin: mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit të fluturimit ajror, njoftimet emergjente, qarkoren e informacionit të fluturimit ajror, kartat e fluturimit ajror, procedurat dhe procedurat e fluturimit;
 - 1.3. Shërbimet meteorologjike që përfshijnë mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit meteorologjik, parashikimin meteorologjik, njoftimet dhe paralajmërimet meteorologjike;
 - 1.4. Instalimi, mirëmbajtja, kontrolli dhe mbikëqyrja e mjeteve teknike, aparateve dhe pajisjeve, për të ofruar shërbime të fluturimit ajror që nënkupton mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, përshtatjen, kalibrimin, monitorimin, mbikëqyrjen, menaxhimin, vendosjen në punë, si dhe zhvillimin, ndryshimin e procedurave, udhëzimet e punës dhe mirëmbajtjen e mjeteve teknike operative në një gjendje që siguron trafik të sigurt dhe të rregullt ajror (CNS Services).
2. Mbajtja e evidencës, mbledhja, përpunimi dhe përcjellja e të dhënave të cilat shfrytëzohen për pagesën e kompensimeve për shërbimet e fluturimit ajror.
 3. Përgatitja dhe përditësimi i rregullt i Përmbledhjes së informacionit të fluturimit ajror.
 4. Trajnimi i stafit të SHNA-së.

1.1 Misioni

Për të siguruar një nivel të lartë të shërbimeve dhe për të përmirësuar vazhdimisht sigurinë, rregullsinë dhe efikasitetin e qarkullimit të trafikut ajror, me shfrytëzimin optimal të burimeve njerëzore dhe teknike të disponueshme dhe me shpenzim minimal për të siguruar shërbime të fluturimit ajror, me cilësi të lartë brenda hapësirës ajrore të projektuar në mënyrë transparente dhe mosdiskriminuese, duke u kujdesur edhe për mjedisin jetësor.

1.2 Vizioni

Të ruhet dhe të përmirësohet vazhdimisht sigurimi i nivelit të lartë të shërbimeve të sigurta, të rregullta, të shpejta, efikase dhe të orientuara nga mjedisi për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore dhe si ofruet i shërbimeve të fluturimit ajror që funksionon në përputhje me rregullat e “Single European Sky”, të përshtatet në kohë me shpenzimet minimale të rregulloreve të reja europiane. SHA “M-NAV” Shkup, duke marrë parasysh të gjitha sfidat, vazhdimisht do të synojë sigurimin e një pozicioni të qëndrueshëm dhe arritjen e rezultateve të larta në punë, duke arritur dhe promovuar vlerat e tij.

1.3 Qëllimet strategjike

- Kujdesi, cilësia dhe siguria – arritja e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare;
- Kapaciteti – të optimizohet kapaciteti i hapësirës ajrore;
- Efikasiteti i shpenzimit – optimizimi i shpenzimeve të shërbimeve;
- SES (Single European Sky) – për të arritur pajtueshmërinë me rregullativat e SES dhe kërkesat që dalin prej tyre;
- Përgatitja e lartë organizative – të arrihet vendosja organizative më e lartë, me qëllim që të përmirësohet menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Mjedisi jetësor – ndjekja dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

1.7 Qëllimet operative

- Të mbahen nivele të larta të kujdesit;
- Të mbahen nivele të larta të sigurisë;
- Të mundësohet shfrytëzimi i kapacitetit të disponueshëm, si dhe të sigurohet zhvillimi i pajisjeve dhe metodave për kërkesat në të ardhmen;
- Të vëzhgohet vazhdimisht lëvizja e kërkesës dhe të përshtatet në mënyrë të duhur planifikimi i kapacitetit;
- Të arrihen nivelet e njësimet dhe kompatibilitetit të sistemit;
- Vendosja e organizimit të lartë dhe cilësia e shërbimeve;
- Të forcohet dhe përforcohet bashkëpunimi rajonal që të marrë një rol të rëndësishëm në rajon;
- Të realizohen qëllimet e planit LSSIP;
- Të arrihen nivelet e nevojshme për të mbrojtur rrethinën;
- Të rritet efikasiteti i shpenzimit;
- Të zhvillojë/mirëmbajë plan të burimeve njerëzore dhe të organizojë trajnim në kohë të personelit të nevojshëm;
- Të mundësohet struktura e hapësirës ajrore duke zbatuar “Cross Border Free Route Airspace” me fqinjët e FIRs.

1.8 Vlerat

- Siguria, si një përparësi kryesore dhe ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për shfrytëzuesit;
- Personel profesional me motiv të lartë, duke ndarë besim dhe respekt të ndërsjellë;
- Reputacion i përsosur; pjesë e një vlere të njohur;
- Përkushtimi për qëndrueshmëri dhe cilësi në punë;
- Vetë-avancim i vazhdueshëm, duke u përpjekur të bëjmë më të mirën;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara;
- Ndarje të njohurive me qëllim që të shfrytëzohen në përmirësimin e punës;
- Menaxhim i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm i organizatës me mjete të arsyeshme;

1.9 Financat

Në përputhje me Ligjin e Aviacionit - Ofruesi i shërbimeve të fluturimit ajror financohet nga:

- pjesa e kompensimit të realizuar në bazë të ofruesit të shërbimeve të fluturimit ajror, shuma e së cilës përcaktohet nga lista e shpenzimeve të ofruesit të shërbimit të fluturimit ajror në një mënyrë të përshkruar në përputhje me nenin 56, paragrafi (4) të Ligjit të Aviacionit;
- kompensimi për trajnimin e stafit të SHNA-së;
- tatimet, huatë, kreditë dhe ndihma të tjera financiare dhe teknike.

1.10 Siguria

Siguria është një përparësi kryesore në aviacion, për të cilën të gjitha vendet anëtare të ICAO

obligohen sipas “Konventës së Çikagos së Fluturimit Ajror Civil”, sipas së cilës ata duhet të ofrojnë shërbime të sigurta të trafikut ajror. Ofrim i sigurt i shërbimeve të fluturimit ajror për avionët është shtylla kryesore e menaxhimit të trafikut ajror. Rritja e vazhdueshme e trafikut ajror do të thotë, që edhe duke ruajtur të njëjtën shkallë të incidenteve, numri i incidenteve do të rritet, gjë që nuk lejohet dhe “M-NAV” ndërmerr të gjitha aktivitetet për të mostejkaluar pragun e caktuar të incidenteve.

Strategjia e ECAC, SESAR (Single European Sky ATM research), rregullativat e SES, si dhe dokumenti strategjik i EASA - EPAS (European Plan of Aviation Safety 2020-2024), përcaktojnë parimet dhe qëllimet për ngritjen e sigurisë në Evropë, në ofrimin e shërbimeve të fluturimit ajror dhe uljen e shkallës së incidenteve ajrore në përputhje me caqet e përcaktuara. Dokumentet e mësipërme janë baza për përcaktimin e qëllimeve strategjike të “M-NAV” dhe përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Republika e Maqedonisë së Veriut është e përfshirë në të gjitha proceset, planet dhe projektet e rëndësishme të parashikuara nga strategjia SESAR, ndërmerr dhe zbaton detyrimet e marra me nënshkrimin e Marrëveshjes ECAA.

Sistemi i përgjithshëm i vendosur dhe ndërkohë i zhvilluar mirë për menaxhimin e sigurisë dhe të sigurimit, si dhe sistemi i cilësisë së “M-NAV”-it janë një bazë e mirë për vazhdimin e ruajtjes dhe përmirësimit të sigurisë së shërbimeve. Rregullativat europiane si dhe shtojca 19 e ICAO kërkojnë jo vetëm ekzistencën e një sistemi të tillë, por i njëjti të ketë efekt dhe të jetë në përputhje me synimet e caktuara të sigurisë.

Njësia e kujdesit, cilësisë dhe sigurisë do të ndërmarrë aktivitetet e përgjithshme për mënjanimin ose zbutjen e mëtejme të rreziqeve, përfshirjen proaktive në përputhje me procedurat e vendosura dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të sistemit të menaxhimit të sigurisë në të gjithë “M-NAV”, në përputhje me Politikën e kujdesit, cilësisë dhe sigurisë, shpërndarjen e mësimave dhe ruajtjen e sigurisë ICT, nëpërmjet akteve të tjera të ndërlidhura.

1.11 Dokumenti LSSIP

Me rritjen e trafikut ajror në rajonin e Evropës, është me rëndës të veçantë për të gjitha vendet europiane, si dhe për ofruesit e shërbimeve të SHNA-së, gjetja një zgjidhjeje që do t'i përgjigjet presionit në aspekt të kapacitetit të hapësirës ajrore, ndikimit në mjedis, siguri, si dhe rritjen e shpenzimeve të linjave ajrore, për shkak të vonësive dhe rritjes së konsumit të karburantit. Sipas gjetjes së atyre zgjidhjeve dhe zbatimit të tyre, EUROCONTROL ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe udhëheqës. Korniza funksionale, e cila përshkruan dhe bashkon të gjitha zgjidhjet teknologjike, avancimin e cilësisë së shërbimit ndaj shfrytëzuesit si dhe zhvillimin e teknologjive të përparuara që dalin nga programi SESAR, që është ATM Master Plan (EATM MP), i cili përditësohet në përputhje me nevojat e të gjithë aktorëve në aviacion. Ky plan në fakt është mjeti kryesor për përcaktimin e përparësive në modernizimin e sistemit ATM, për të realizuar qëllimet e vendosura nga SESAR. Përveç kësaj, ky plan përshkruan edhe arsyet si dhe afatet kohore për veprimet e përbashkëta të dakorduara që do të ndërmerren nga të gjitha palët e interesuara në rrjetin e përgjithshëm ajror evropian.

Dokumentet e LSSIP (Local Single Sky Implementation) janë pasqyrim i drejtpërdrejtë i angazhimit të agjencive nacionale civile dhe ushtarake, ofruesve të shërbimeve të fluturimit ajror dhe operatorëve të aeroportit, në zbatimin e EATM MP-së. Këto dokumente japin një pasqyrë e detajuar vjetore të progresit në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara që dalin nga plani i përmendur, si dhe rregullativa europiane e aviacionit, për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian, vendet e rajonit të ECAC-së, por edhe për vendet që kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me EUROCONTROL. Cilësia e të dhënave nga dokumentet e LSSIP, u mundëson atyre që të jenë burimi i vetëm për disa vjet në përgatitjen e raportit mbi zbatimin e ICAO Aviation “System Block Upgrades” (ASBUs), për

zonën ICAO/EUR.

Progresi në arritjen e qëllimeve të zbatimit analizohet çdo vit nga ekipi i EUROCONTROL, dhe pastaj bëhen përshtatje dhe iniciativa të caktuara, për të përmirësuar secilin vend anëtar, për arritjen e qëllimeve.

Për informacion, realizimi i qëllimeve të zbatimit në nivelin e të gjitha palëve të fluturimit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është 24%.

1.12 Bashkëpunimi rajonal

Sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe aktiviteteve të ndërmarra për krijimin e blloqeve funksionale të hapësirës ajrore (FAB), Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2006 nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë. Maqedonia është anëtare e ISIS (Implementation of Single European Sky in South East Europe), e cila është iniciativë për zbatimin e rregullativës së Qiellit të Vetëm European (SES) në zonën e Evropës Juglindore dhe është nën kujdesin e Komisionit European.

Në vitin 2015 Republika e Maqedonisë së Veriut fitoi statusin e vëzhguesit në Danub FAB dhe u confirmua zyrtarisht në takimin e Këshillit Drejtues të Danubit FAB, në tetor të vitit 2015, në Sofje.

Në vitin 2020 Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, në emër të Qeverisë së RMV-së, nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi për anëtarësimin e asociuar në BLUEMED FAB. Më 1.12.2015, "M-NAV" fitoi statusin e anëtarit në iniciativën rajonale të ofruesve të shërbimeve të fluturimit ajror "GATE ONE".

Për të arritur disa nga qëllimet e ESSIP, dhe kështu për të forcuar bashkëpunimin, "M-NAV" koordinon disa aktivitete me shërbimet ATS të vendeve fqinje. Në atë drejtim, Republika e Maqedonisë së Veriut promovon dhe rrit gjithmonë bashkëpunimin në rajon përmes pjesëmarrjes së saj aktive në disa iniciativa dhe marrëveshje rajonale siç janë:

- Pjesëmarrja në "Balkan Aviation Normalization Meeting" dhe në grupet punuese të "Air Traffic Management Committee" të NATO-s;
- Pjesëmarrja në trupat përkatës dhe grupet e punës të Eurocontrol dhe ICAO;
- Pjesëmarrja në iniciativën rajonale "Joint Service Provision Area";
- Marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave të radarit me Bullgarinë, Shqipërinë, Serbinë, Greqinë dhe Hungarinë (për nevojat e menaxhimit të trafikut në territorin e Kosovës);
- Bashkëpunim bilateral për koordinim në fushën e "Air Traffic Management" dhe "Communication Navigation Surveillance" me të gjitha vendet fqinje;
- Marrëveshje bashkëpunimi dhe marrëveshje për sigurimin e radarit dhe shërbimit të radiokomunikimit të Hungarocontrol për nevojat e sigurimit të shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror për fluturimet mbi Kosovë;
- Në vazhdim është edhe procedura për nënshkrimin e një marrëveshjeje me Shqipërinë në lidhje me delegimin e ATS (zona afër e hapësirës ajrore shqiptare pranë aeroportit të Ohrit është deleguar në RM që të lehtësojë operacionet terminale në aeroportin e Ohrit);
- Marrëveshje e veçantë bashkëpunimi me NATO-KFOR;
- Pjesëmarrja si vëzhgues në punën e Danube FAB dhe BLUEMED FAB;
- Pjesëmarrja në punën e "GATE ONE";
- "M-NAV" është anëtar i plotë në CANSPO (Civil Air Navigation Service Provider Organisation), anëtarësim i cili është një përfitim i rëndësishëm për "M-NAV", veçanërisht në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

1.13 Përmirësimi i strukturës së hapësirës ajrore

Gjatë vitit 2020 vazhduan aktivitetet dhe negociatat për normalizimin e trafikut ajror në pjesën e poshtme të hapësirës ajrore mbi Kosovë, me zbatimin e një interfejsi të ri midis Kosovës dhe Shqipërisë, që sjell trafik nga/në aeroportin e Prishtinës duke arritur/nisur drejt destinacioneve në Europën veriperëndimore, tanimë nuk do të fluturojë mbi hapësirën ajrore të RMV-së, që do të çojë në zvogëlimin e kompleksitetit të hapësirës ajrore dhe ngarkesës operative të personelit operativ.

2. **SEKTORI I FLUTURIMIT AJROR**

Sektori i fluturimit ajror – SFA, si sektor kryesor operativ në sistemin e ofrimit të shërbimeve të fluturimit ajror, ka përgjegjësi kryesore që të sigurojë kryerjen e veprimtarisë kompetente, profesionale dhe cilësore, ndërsa para së gjithash, të sigurojë zhvillim të sigurt, efikas dhe të rregullt të trafikut ajror.

Aktiviteti i SFA-së është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë e trafikut ajror dhe detyra kryesore e SFA-së është mbajtja e nivelit të lartë të sigurisë gjatë punimit dhe marrja e përhershme e masave për përmirësimin e sigurisë.

2.1. **Qëllimet strategjike të SFA-së**

Si rezultat i qëllimit prioritar të punës së sigurisë së SFA-së, do të punohet intensivisht mbi përmirësimin e sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe zbatimin e procedurave dhe proceseve të lidhura me sigurinë, që rrjedhin nga standardet e miratuara të organizatave ndërkombëtare dhe europiane relevante të fluturimit ajror (ICAO-ja dhe Eurocontrol-i).

Në përputhje me trendin european të punimit me kosto efektive, gjatë vitit 2021 dhe në vazhdimësi më tutje, SFA-ja planifikon të marrë një varg aktivitete që do të mundësojnë punë financiare të qëndrueshme. Strategjia për realizimin e këtij qëllimi bëhet nëpërmjet:

- Planifikimit në kohë dhe analitik të punës;
- Optimizimit të stafit dhe burimeve të disponueshme;
- Trajnimit të kontrolluesve të rinj të fluturimit, me qëllim riekupimin dhe ripërtëritjen e stafit;
- Bashkëpunimit të vazhdueshëm rajonal;
- Planifikimit të infrastrukturës së rrugëve aërore në aspekt që të mundësohen kahje më të shkurtra dhe tërheqja e një sasive më të madhe të trafikut në hapësirën e poshtme ajrore.
- Intensifikimit të bashkëpunimit me qendrat fqinje të KF-së, me qëllim zgjerimin e konceptit FRA përtej kufijve të hapësirës kompetente. Për këtë qëllim veçse është mbajtur mbledhje bilaterale me BULATSA-n, ofruesin e shërbimeve të fluturimit ajror të Bullgarisë fqinje, ndërsa takime të tilla janë planifikuar përgjatë vitit 2021 edhe me vendet e tjera fqinje dhe projektin SECSI (Southeast Europe Common Sky Initiative);
- Përmirësimit të shërbimit "environmental saving"(ruajtja e ambientit), që do të realizohet nëpërmjet pjesës së aktiviteteve të lartpërmendura për implementimin e rrugëve më të shkurtra aërore dhe zgjerimin e FRA-së me vendet fqinje dhe më gjerë në rajon, me çka do të ulet shpenzimi i karburantit dhe shpenzimet e pasagjerëve dhe do të ulet emetimi i gazrave të dëmshme në atmosferë, si dhe zbatimi i sistemeve dhe teknologjive të reja dhe
- Marrjes së aktiviteteve të tjera që janë pjesë e planifikimit strategjik afatgjatë.

SFA-së vazhdimisht i imponohet nevoja e vëzhgimit të zhvillimit të teknologjisë dhe teknikës në fushën e aparaturave dhe sistemeve që janë bazë e ofrimit të shërbimeve të kontrollit të fluturimit. Në përputhje me trendin zhvillues të funksioneve të sistemeve për kontrollin e fluturimit të diktuar nga standardet paneuropiane, gjatë vitit 2021 do të vazhdohet me procesin e zbatimit të sistemit të ri për kontrollin e fluturimit në Shkup. Ky proces që paraqet një investim kapital, i cili është përfshirë në programin e deponimeve investuese në përbërjen e planit vjetor financiar të M-NAV-it për vitin 2021, është vështirësuar për shkak të paraqitjes së pandemisë me Kovid-19 dhe ndikon seriozisht në realizimin e shumë qëllimeve strategjike të M-NAV-it.

Themelimi i bashkëpunimit të ngushtë me shfrytëzuesit komercialë të shërbimeve të fluturimit ajror (IATA, IACA, avio-kompanitë më të përfaqësuara të ne), është bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të kontrollit të fluturimit dhe përshtatjen e të njëjtit ndaj nevojave të vazhdueshme të shfrytëzuesve.

Si faktor ndikues për sigurinë e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kontrollit të fluturimit është edhe posedimi i rregullave qartë të përcaktuara të bashkëpunimit me njësitë fqinje të KF-së,

por gjithashtu edhe me të gjithë shfrytëzuesit civil vendas (klubet ajrore, fluturimi ajror bujqësor, shoqëritë paraglajder etj.) dhe shtetërorë (ushtarakë dhe policorë) të shërbimeve të KF-së. SFA-ja vazhdimisht ndërmerr aktivitete të kësaj fushe lidhur me revizionin e marrëveshjeve të reja për bashkëpunim, ato ekzistuesve dhe të përpiluara, që janë themelore për ofrim të sigurt dhe cilësor të shërbimit të kontrollit të fluturimit.

Vazhdimi i zbatimit të FUA-së, si pjesë e proceseve për mbështetje të aktiviteteve që rrjedhin nga anëtarësia në NATO.

Si pjesë e aktiviteteve që rrjedhin nga kërkesat e BE-së dhe rregulativave të BE-së, është nevoja e ekzistimit të programeve të caktuara për trajnim dhe certifikim të kuadrove, si dhe programet e ruajtjes së vazhdueshme të kompetencës. Për atë qëllim një pjesë e madhe e aktiviteteve të SFA-së kryesisht është e orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të profesionalizmit, përmes ndjekjes së trajnimeve të avancuara dhe ruajtjes së rregullt të kompetencës së kuadrit në nivel të lartë. Pjesë e aktiviteteve të lidhura me procesin e ruajtjes së kompetencës, është nevoja për trajnimin e kuadrove, për çka nevojiten mjete financiare, që janë të planifikuara dhe të parashikuara për vitin 2021.

Gjatë vitit 2018 është punuar në përzgjedhjen e kandidatëve për kontrollues të fluturimit, me qëllim të riekipimit të stafit të M-NAV-it në këtë segment. Në vijim është trajnimiti 11 kandidatëve të përzgjedhur në vendin e punës, për marrjen e lejeve përkatëse, i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021. Ky trajnim gjithashtu u ndikua nga pandemia me Covid-19, por SFA-ja i mori të gjitha aktivitetet për plotësimin e duhur të trajnimit edhe gjatë vitit 2021.

SFA-ja vazhdimisht do të punojë në rishikimin dhe plotësimin e programeve të brendshme për punë, por edhe për trajnimet dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin e miratuar europian dhe standardet e organizatave europiane dhe ndërkombëtare relevante të fluturimit ajror, si dhe me legjislacionin e vendit.

Është fakt se procesi i marrjes së autorizimit për ushtrimin e punës së kontrollit të fluturimit kërkon trajnim afatgjatë, planifikimi i burimeve njerëzore, gjegjësisht trajnimiti i kuadrove kërkon planifikim cilësor dhe në kohë. Në këtë proces duhet të mbahet llogari për zhvillimin e sistemit, planifikimin e sektorëve të ardhshëm dhe numrin e realizuesve që ata e kërkojnë, mundësinë e shfrytëzimit të stafit, si dhe procesin e pashmangshëm të pensionimit.

2.2. Aktivitetet për realizimin e synimeve të SFA-së

Aktivitetet për realizimin e synimeve të SFA-së në periudhën e vitit 2021, janë paraqitur në tabelë si një pasqyrë më e qartë, dhe janë prezantuar përmes qëllimeve, nënqëllimeve, kohës së realizimit dhe bartësve të përgjegjës.

	Nënqëllimet - Aktivitetet	Korniza kohore e planifikuar për realizim		Koordinatori i realizimit	Koha e përfundimit të aktiviteve		Komenti
		Nga	Deri në		Nga	Deri në	
1.	Zvogëlimi i kufizimeve të hapësirës ajrore të Route Availability Documents (RAD) dhe ENV (Environmet), me qëllim që të mundësohet përdorimi i hapësirës ajrore.	Janar 2021	Dhjetor 2021	SFA, NJSKF/FMP			Në vijim
2.	Implementimi i sistemit të ri operativ për kontrollin e fluturimit, në përputhje me kontratën.	Prill 2019	Dhjetor 2021	SFA / STA			Në vijim. Për momentin për shkak të pandemisë dhe shfaqjes së klauzolës së fuqisë madhore, të gjitha aktivitetet po realizohen me shpejtësi të ngadaltë. Varësisht nga zhvillimi i ardhshëm i gjendjeve me pandeminë, planifikohet që aktivitetet të vazhdojnë me dinamikën e parashikuar. Afati i fundit i përfundimit të implementimit varet nga përfundimi i klauzolës së fuqisë madhore dhe nuk mund të parashikohet.
3.	Plotësimi dhe përditësimi i versionit ekzistues të udhëzimit për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror.	Janar 2021	Dhjetor 2021	SFA, NJSKF/FMP, APP/TVR			Sipas nevojave
4.	Implementimi i stacionit të ri Automatic Weather Observation System - AWOS / Automated Terminal Information System - ATIS/ Sistemi informatik meteorologjik për mjetet ajrore në fluturim - VOLMET	Janar 2015	Mars 2021	SFA / SFA			Zëvendësimi i stacionit ekzistues AWOS 2000/Automated Terminal Information System - ATIS/VOLMET. Vazhdojnë aktivitetet për lëshimin e certifikatës SAT.
5.	Zbatimi i OLDI-t me kontrollin e fluturimit në Selanik	Janar 2021	Dhjetor 2021	SFA / STA			Takime dhe aktivitete nxitëse deri në fund të vitit 2021.
6.	Implementimi i OLDI-t me kontrollin e fluturimit në Prishtinë	Janar 2021	Dhjetor 2021	SFA/ STA			
7.	Implementimi i mesazhit REV me ACC Athinë	Shkurt 2020	Shkurt 2021	SFA/ STA			Aktivitetet nistore janë të nisura në 2019.

	Nënqëllimet - Aktivitetet	Korniza kohore e planifikuar për realizim		Koordinatori i realizimit	Koha e përfundimit të aktiviteteve		Komenti
		Nga	Deri në		Nga	Deri në	
8.	Vazhdimi i realizimit të Planit aksionar për përpunimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë (Action Plan for enhancement of Safety Management System) në bashkëpunim me Eurocontrol-in.	Janar 2021	Dhjetor 2021	SFA, STA dhe Njësia e SSC-së			Në vijim
9.	Përditësimi dhe realizimi i planit për përpunimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe procedurat për mirëmbajtjen e vazhdueshme të kushteve të parashikuara të nevojshme për mirëmbajtjen e standardeve të certifikimit.	Janar 2021	Dhjetor or 2021	SFA, STA dhe Njësia e SSC-së			Në vijim
10.	Optimizim i kapaciteteve të hapësirës ajrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes implementimit të analizave dhe marrjes së masave për zmadhimin e kapaciteteve të sektorëve rajonal, ndarjes më efektive të sektorëve të hapësirës ajrore, hapësirës më profitabile të sektorit dhe ndarjes më adekuate të stafit operativ (kontrolluesit të fluturimit) varësisht nga periudha e vitit dhe dendësia e trafikut.	Janar 2021	Dhjetor or 2021	SFA, NJSFK /FMP			Në vijim *
11.	Ndryshimet e organizimit dhe klasifikimit të hapësirës ajrore të FIR Shkup, me qëllim mundësimin e punës së njësive TMA, NJSK dhe AKF Ohër	Maj 2018	Maj 2021	SFA/AIS			Në vijim
12.	Dualizimi i pikës RAXAD, me qëllim lëvizje më të madhe dhe efikasitet të trafikut	Tetor 2018	Dhjetor or 2021	SFA / AIS			E shtyrë sipas kërkesës së SMATSA-së, që të bëhen përpjekje të ripërtëritet koordinimi në lidhje me implementimin.

	Nënqëllimet - Aktivitetet	Korniza kohore e planifikuar për realizim		Koordinatori i realizimit	Koha e përfundimit të aktiviteve		Komenti
		Nga	Deri në		Nga	Deri në	
Njësia për furnizim dhe investim në përbërje të Sektorit për punë financiare, punë juridike, zhvillim dhe investim i zbaton procedurat për furnizim, në pajtim me Ligjin e Furnizimeve Publike të RMV-së (definimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve të cilat duhet të furnizohen, mënyrën dhe ndjekjen e realizimit të furnizimit, si dhe mënyrën e zgjedhjes së furnizuesit). Që do të thotë se procesi i furnizimit, nënkupton furnizim të mallrave, shërbimeve dhe punëve, që kryhet sipas Ligjit të Furnizime Publike të RMV-së,

ndërsa njësia për furnizime dhe investime menaxhon me veprimet për përgatitje dhe realizim të procesit për furnizim.

Aktivitetet e planifikuara të Njesisë për furnizim dhe investim për vitin 2021 janë si në vijim:

- Përgatitja e planit vjetor për furnizime publike Deri në 31.1.2021 – vitin vijues për të cilin bëhet fjalë. Në planin vjetor janë të planifikuara furnizimet në nivel vjetor në bazë të kërkesës nga Sektorët dhe Njësitë, ndërsa sipas nevojave për realizim të planit Financiar për punë të SHA “M-NAV”-it Shkup për vitin vijues;
- Plani për furnizime publike mund të ndryshojë dhe plotësojë varësisht nga nevojat e organit kontraktues pas marrjes së vendimit nga Këshilli Administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit të Furnizimeve Publike;
- Njësia për furnizime publike dhe investime do ta ndjekë Rregullativën Ligjore në lidhje me furnizimet publike dhe do të kujdeset për zbatueshmërinë e dispozitave ligjore në procesin e furnizimit;
- Njësia për furnizim dhe investim do t'i realizojë furnizimet e planifikuara nga plani vjetor varësisht nga nevojat reale dhe situata financiare në vitin vijues;
- Do të përgatisë vendime për nevojat nga furnizimet publike për formimin e Komisionit për Furnizime Publike;
- Në pajtim me pranimin e specifikimit teknik të iniciatorëve të furnizimit, përkatësisht personat përgjegjës nga tre sektorët e SHA “M-NAV” Shkup, njësia për furnizime do të fillojë me zbatimin e veprimeve për furnizime publike, me atë që do t'i përgatisë dokumentacionet e tenderëve;
- Dokumentacionin e tenderit bashkë me letrën përcjellëse, varësi për çfarë lloj të veprimit bëhet fjalë, do ta shpallë në faqen e internetit të Byrosë për Furnizime Publike ose përderisa është e nevojshme në mediet zyrtare publike në Evropë;
- Njësia për furnizime detyrimisht merr pjesë si anëtare në Komisionin për Furnizim Publik te veprimet për ndarje të kontratës për furnizime publike me vlerën mbi 130.000 euro në kundërvlerë të denarit për mallrat dhe shërbimet edhe mbi 5.000.000 euro për punët (në këto kontrata për furnizime publike obligohet pjesëmarrja e personit i cili posedon vërtetim për provim të dhënë, me qëllim zbatim më profesional dhe më përgjegjës në procedurën e ndarjes së të njëjtës);
- Njësia për furnizim do të marrë pjesë në Komisionet për Furnizime Publike dhe do ta zbatojë procesin e evaluimit të ofertave të arritura, si dhe do të përgatisë Raport nga zbatimi i veprimit për të njëjtën. Pastaj, pas prezantimit të raportit dhe kontrollimit të veprimit për zgjedhje nga ana e drejtorit ekzekutiv të Sektorit për punë financiare, punë juridike, zhvillim dhe investim, Njësia për furnizime dhe investime do të përgatisë vendim për zgjedhje të ofertuesit më të mirë;
- Njësia për furnizime i njofton të gjithë ofertuesit për rezultatet dhe zgjedhje të ofertuesit dhe pas skadimit të afatit ligjor merr pjesë në përpunimin e kontratës për furnizim me zgjedhje të ofertuesit;
- Njësia për furnizime çdo kontratë do ta shpallë në faqen e internetit të Byrosë së Furnizimeve Publike dhe do të mbajë evidencë të veprimeve në pajtim me llojin e paraparë të veprimit. Do të paraqesë raport gjysmëvjetor te Byroja e Furnizimeve Publike për zbatimin e furnizimeve. Sipas saj, Njësia për furnizime dhe investime do të udhëheqë edhe evidenca të tjera interne dhe do të përgatisë raporte të ndryshme për nevojat e vetë njesisë dhe drejtorëve të “M-NAV”-it;

- Njësia për furnizime çdo kontratë të realizuar do ta shpallë në faqen e internetit të Byrosë së Furnizimeve Publike;
- Njësia për furnizime jep drejtime dhe udhëzime në lidhje me veprim të procedurës së ankimit, në afat prej 5 ditëve të punës pas marrjes së ankesës, Njësia për furnizime dhe investime në bashkëpunim me Komisionin për Furnizime Publike dhe Njësinë për punë juridike, përgatit dhe jep përgjigje për ankesën e parashtruar deri te Komisioni Shtetëror për ankesa rreth furnizimeve publike; Përgjigjen e ankesës e nënshkruan Drejtori ekzekutiv i sektorit për punë financiare, punë juridike, zhvillim dhe investim dhe e bashkangjet në SEFP;
- Njësia për furnizime do të zbatojë edhe aktivitete tjera, varësisht nga lloji i procedurës për furnizim të mallit, shërbimit ose punës.

4.6 Aktivitetet e planifikuara të Njesisë së marrëdhënieve me publikun

Njësia e marrëdhënieve me publikun merr pjesë në zhvillimin dhe unifikimin e politikave brenda fushës së punës së njesisë dhe koordinimin e tyre, komunikimin me organet e administratës shtetërore, organe dhe organizata të tjera, organizimin e konferencave për shtyp, shpërndarjen e njoftimeve në lidhje me punën e shoqërisë, menaxhimin e paraqitjes në media; organizimin e takimeve, konferencave për shtyp, bartjen e informacioneve brenda dhe jashtë kompanisë; bashkëpunimin me të gjitha institucionet në vend dhe jashtë vendit, që janë në interesin tonë dhe që nuk kanë të bëjnë me ato aktivitete që ne i kemi zhvilluar; ndihmon shoqërinë për të ndërtuar vullnet të mirë me përkrahje dhe pjesëmarrje në ngjarjet e rëndësishme kulturore, arsimore, sportive, të lidhura me kujdesin shëndetësor, duke promovuar kështu, vlerat universale të pranuar rreth vetëdijes për mjedisin; organizimin e seminareve, konferencave për temat në lidhje me fluturimit ajror; rezervimin e biletave të avionit dhe sigurimin e akomodimit në hotel për udhëtarët e biznesit; prerjen e sigurimit të udhëtimit.

Organizimi dhe realizimi i kërkesave për vizita në shoqëri nga të ftuarit e huaj dhe vendas.

Pjesëmarrja në Njësinë e zbatimit të projekteve të financuara nga fondet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe të ndihmave, si dhe mbështetje e plotë tekniko-administrative në procedurat individuale për realizimin e komponentëve të projekteve individuale në përputhje me marrëveshjet e lidhura për hua.

Njësia e marrëdhënieve me publikun merret me politikën e reklamimit të subjektit, nëpërmjet ngritjes së imazhit të korporatës; kujdeset për faqen e internetit të "M-NAV"-it; mirëmbajtjen dhe përditësimin e adresave të shoqërisë në rrjetet sociale, duke publikuar lajme/ngjarje; përgatitjen e botimeve in-house; prezantimeve vizuale; siguron edukimin e publikut në lidhje me rëndësinë e SHA "M-NAV", për funksionimin normal të trafikut ajror; për t'ia paraqitur më afër publikut funksionimin e SHA "M-NAV"; siguron marrëdhënie të mira me institucionet politike dhe jo politike; siguron marrëdhënie të mira me Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve. Njësia e marrëdhënieve me publikun merr pjesë në zbatimin e aktiviteteve që i referohen protokollit të kompanisë kur organizon mbledhje, punëtori, seminare, trajnime, festa etj.

Përkthimi i dokumentacionit të brendshëm dhe të jashtëm, shkresave, raporteve mediatike nga maqedonishtja në shqipe dhe nëse është e nevojshme, përkthime nga anglishtja në maqedonishte, shqipe dhe anasjelltas.

Qendra e trajnimit IANS në Eurocontrol si një "focal point"/ person për kontakt në organizatën tonë në lidhje me kurset/ trajnimet që janë të ofruara për stafin e fluturimit ajror EUROCONTROL, siguron trajnim për kontrollorët evropianë të fluturimit, operatorët e linjave ajrore, stafin për menaxhimin e fluksit të ekuipazhit, menaxherët e trafikut të aviacionit dhe ekspertët e aviacionit. Programi i trajnimit përfshin Menaxhimin e Trafikut Ajror (MTA), komunikimet, navigacionin dhe mbikëqyrjen.

Sigurimi i informacionit në lidhje me procesin e aplikimit, sigurimi i të gjitha informacioneve të nevojshme për një kandidat, për të plotësuar të gjitha kushtet për pjesëmarrje në një nga kurset/ trajnimet e IANS-it.

4.7 Aktivitetet e planifikuara të Njesisë së burimeve njerëzore

Njësia e burimeve njerëzore kryen punët dhe detyrat lidhur me të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të SHA "M-NAV" Shkup, si më poshtë:

- zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, marrëveshjeve kolektive dhe rregulloreve të tjera që lidhen me statutin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve në fushën e marrëdhënieve të punës;
- përgatitje të akteve të përgjithshme dhe individuale të të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisve të punonjësve; mbajtja e evidentimit personal në SHA "M-NAV" Shkup;
- mbajtje të regjistrave e shënuar si detyrim me rregulloret ligjore dhe rregulloret e tjera nga fusha e punës;
- mbajtje të shënimeve për praninë e punonjësve dhe shfrytëzimin e orëve të punës, përgatitje të raporteve dhe i paraqet ato në shërbimin profesional për pagimin e pagave dhe shtesave të pagave;
- regjistrimin dhe çregjistrimin i punonjësve në organet kompetente dhe shërbimet profesionale;
- mbikëqyrje dhe zhvillim të politikës së personelit në SHA "M-NAV" Shkup;
- përgatitje të analizave, informacioneve dhe raporteve për gjendjen e personelit në SHA "M-NAV" Shkup;
- udhëheqje të personelit të vetëm dhe evidencës personale në SHA "M-NAV" Shkup; mbikëqyrje të nevojës për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas sistematizimit të punëve dhe detyrave dhe në lidhje me këtë, bashkëpunimin me drejtuesit e njësive organizative të SHA "M-NAV" Shkup;
- përzgjedhje dhe punësim të burimeve njerëzore;
- përgatitje dhe kryerje të sondazheve dhe analizave për vlerësimin e procesit të punës, propozimin dhe përgatitjen e procedurave për kryerjen cilësore të detyrave të punës;
- përgatitje të mendimeve për çështje që kanë të bëjnë me burimet njerëzore;
- udhëheqje të diskutimeve me udhëheqësit në lidhje me treguesit e shpërblimit, si dhe përgatitje të procedurave disiplinore;
- pjesëmarrje në përgatitjen e një programi vjetor të trajnimit dhe përgatitje të rregulloreve të punës në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive;
- përgatitje të rregullave për organizim dhe sistematizim, rregulloreve të shpërblimit;

- propozim të politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore në SHA “M-NAV” Shkup;
- koordinim dhe përgatitje të planit për shfrytëzimin e pushimeve dhe përgatitja e aktvendimeve për pushimet vjetore;
- propozim të masave për t’u siguruar punonjësve kushte optimale për punë;
- informim i punonjësve për masat dhe konkluzionet e miratuara nga Qeveria e RMV-së për mbrojtjen nga KOVID-19;
- mbikëqyrje dhe studime i përvojave teorike dhe praktike në vend dhe jashtë vendit për punë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- kryerje të veprimtarive të tjera që do t’i përcaktohen brenda fushës së kompetencave në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tjera.

Nëse vlerësohet që e njëjta të bëhet një herë në vit, Njësia e burimeve njerëzore planifikon të përgatisë pyetësorë anketues për të vlerësuar kënaqësinë e punonjësve dhe për t’i pranuar dhe zbatuar komentet e tyre në propozimet për rishikimin e Strategjisë së përgjithshme të shoqërisë dhe Marrëveshjes k o lektive.

Njësia e burimeve njerëzore përkujdeset për zbatimin e konceptit të shpërblimit dhe përfitimeve për punonjësit, në përputhje me Marrëveshjen Kolektive të nënshkruar nga Shoqëria:

- niveli i pagave;
- zbatimi i përfitimeve dhe praktikimi i atyre ekzistuese (telefonatat me pagesë, sigurimet, çmimet jubilarë, pagat për pushime etj.)

Trajnime, zhvillime personale, profesionale dhe edukim

Trajnime të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2021, me kontaktet tashmë të vendosura me qendrat edukative dhe me trajnuesit e brendshëm, do të bëhen trajnime të stafit.

Në përputhje me politikën për zhvillimin personal dhe profesional të punonjësve, mbikëqyrja e risive në punë, përkatësisht ofrimi i shërbimeve, krijon nevojën për trajnim dhe arsimim shtesë, të përhershëm. Disa nga punonjësit janë pjesë e projektit për përmirësimin dhe kontrollin afatgjatë të punës dhe aftësive të tyre shëndetësore.

4.8 Aktivitetet e planifikuara të Njesisë së çështjeve ligjore

Njësia e çështjeve ligjore në përputhje me kompetencat e saj gjatë vitit 2021 do të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitjen e akteve të përgjithshme të shoqërisë, me kërkesë të Asamblesë së shoqërisë, Bordit mbikëqyrës dhe Bordit të drejtorëve;
- Përgatitjen e akteve dhe materialeve të tjera profesionale, për nevojat e Drejtorit Ekzekutiv të Sektorit të çështjeve financiare, çështjeve ligjore, zhvillimit, investimeve dhe Bordit drejtues;
- Përgatitjen e vendimeve dhe konkluzioneve të miratuara në seancat e Bordit drejtues, në koordinim me asistentin e biznesit të kryetarit të Bordit drejtues;
- Dhënien e mendimit lidhur me propozim-ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e fluturimit ajror;

- Ndërmarrjen e veprimeve para gjykatave kompetente në koordinim me zyrën e angazhuar të avokaturës (zyra ligjore);
- Dhënien e ndihmës juridike për çështjet ligjore të paqarta të Bordit të drejtorëve dhe sigurimin e ndihmës juridike në të gjitha keqkuptimet ligjore ndërmjet SHA “M-NAV”, Shkup dhe personave të tjerë juridikë;
- Mbikëqyrjen e përputhjes së akteve të përgjithshme të SHA “M-NAV” Shkup me ligjet dhe rregulloret e tjera duke propozuar aktivitetet e duhura për harmonizimin e tyre;
- Pjesëmarrjen në punën e grupeve të punës dhe komisioneve;
- Përgatitjen e informacioneve dhe raporteve brenda kompetencës së Njesisë së çështjeve ligjore me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve, Sekretariatit të Legjislacionit, organeve dhe institucioneve të tjera të përfshira;
- Kryerjen e punëve dhe detyrave të tjera brenda kompetencave të kësaj njësie që do t'i besohen Drejtorit ekzekutiv të çështjeve financiare, çështjeve ligjore, zhvillimit, investimeve dhe Bordit të drejtorëve.

4.9 Aktivitetet e planifikuara të Njesisë së punëve të përgjithshme

Njësia e punëve të përgjithshme është një formë e brendshme organizative brenda Sektorit të çështjeve ligjore, financiare, zhvillimit dhe investimeve, i përbërë nga punëtorët që kryejnë detyra pune për: sigurimin e personave dhe pasurisë, mirëmbajtjen e higjienës, shoferëve dhe mirëmbajtjes së kopshtit.

Siguria për nevoja vetjake do të bëhet në dy objekte të SHA “M-NAV”, Shkup, me sigurimin fizik dhe/ ose me sigurimin mbikëqyrës (sisteme të vëzhgimit me kamerë), në përputhje me Ligjin e Sigurisë Private (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 166, datë 26.12.2012) dhe 164, datë 27.11.2013) dhe Udhëzimin e punës për mënyrën e kryerjes së punës së sigurimit.

Në përputhje me detyrat e punës që burojnë nga sistematizimi i vendeve të punës, punëtorët që punojnë në mbajtjen e higjienës do të kryejnë detyrat e tyre në tre objektet e M-NAV-it. Gjithashtu, në mënyrë periodike, sipas një plani të përcaktuar më parë, do të trajtohen të gjitha objektet e dislokuara, në të cilat janë të vendosura mjetet (pajisjet) për trafikun e sigurisë ajror që janë kompetencë e M-NAV-it.

Shoferët, gjatë vitit 2020, do të kryejnë detyrat e tyre të punës, në përputhje me Rregulloren e mënyrës së përdorimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të M-NAV-it, si dhe detyrimet e punës që janë të përcaktuara për vendet e punëve përkatëse në sistematizim.

Gjatë vitit 2020, bashkëpunimi dhe realizimi i aktiviteteve të tanishme do të vazhdojë me Drejtorinë e Sigurisë së Informacioneve të Klasifikuara.

Do të vazhdojnë aktivitetet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen si ekspert në zbatimin e prokurimeve publike (prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve, duke mbledhur oferta pa ose me publikimin e shpallur, procedura të hapura, procedura të negociuara pa shpallje paraprake etj.), në përputhje me planin e prokurimit publik të M-NAV-it për vitin 2020.

Në periudhën e përmendur, është planifikuar të përgatiten dhe jepen distinktivë të rinj identifikimi, të cilët, në të njëjtën kohë do të funksionojnë edhe për evidentimin e orëve të punës edhe për kontrollimin e mbërritjes së punonjësve në vendin e punës M - NAV.

Ndërrimi i distinktivëve të identifikimit do të bëhet edhe për punonjësit operativë të objekteve të KTA-së në Aeroportin e Shkupit dhe Ohrit, ku detyrat e tyre të punës i kryejnë edhe në zonat "air side" të aeroporteve të Shkupit dhe Ohrit.

Do të vazhdojë bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me shërbimet e MPB-së, ARM-së dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit dhe aeroportit "Shën Apostol Pali" të Ohrit, në lidhje me kontaktet që bëhen në situata të rregullta dhe jo të rregullta të lidhura me M-NAV-in.

Do të merr pjesë në disa seminare të planifikuara profesionale në lidhje me zbatimin konsistent të Ligjit të Qasjes së Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, Ligjit të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Ligjit të Sigurisë së Personave dhe të Pronës.

4.10 Aktivitetet e planifikuara të Njesisë së punës së zyrës dhe arkivit

Njësia e punës së zyrës dhe arkivit si pjesë e Sektorit të çështjeve financiare, çështjeve ligjore, zhvillimit dhe investimit, në vitin 2020 do të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Udhëheqjen e punës së zyrës dhe arkivit, marrjen, përcjelljen dhe rregullimin e postës, organizimin dhe drejtimin e punës në njësi, është përgjegjës për kryerjen në kohë, në mënyrë ligjore dhe cilësore të punëve dhe detyrave në njësi;
- Dorëzimin e udhëzimeve dhe zbatimin e udhëzimeve të dhëna, si dhe dhënien e udhëzimeve për kryerjen e detyrave të punës;
- Kontrollimin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë për kryerjen në kohë të punëve dhe detyrave në njësi;
- Përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e vulave dhe vulave katrore, për hyrjen dhe daljen në kohë të dokumenteve, arkivit elektronik dhe regjistrin elektronik;
- Realizimin e bashkëpunimit në punët brenda fushës së njesisë me njësitë dhe sektorët e tjerë, si dhe respektimin e personalitetit dhe dinjitetin e palëve;
- Përgjegjës i drejtpërdrejtë për punën e tij para udhëheqësit të sektorit, kryen edhe veprimtari të tjera të përcaktuara me aktin për sistematizimin brenda kornizave të ligjit dhe rregulloreve;
- Përgjegjës për të gjithë punën administrative teknike: organizimin e punës që ka të bëjë me klientët, organizimin e mbledhjeve, mbajtjen e procesverbaleve dhe regjistrave, si dhe verifikimin e transkriptimeve, nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve;
- Posedimin e një biblioteke profesionale dhe e të gjitha materialeve të nevojshme për punë në zyrë dhe arkiv, për të zbatuar parimin e njëtrajtshmërisë, saktësisë, zhdërvjelltësisë, njëshmërisë, qartësisë dhe ekonomizimit;
- Kryerjen e regjistrimit, klasifikimit, shtyrjes dhe ruajtjes së akteve, si dhe punës arkivore, d.m.th. zgjedhjen e materialit arkivor nga materiali dokumentar, rregullimin e materialit arkivor dhe materialit dokumentar, evidentimin e materialit arkivor, regjistrimin e materialit arkivor, datën e skadimit e të cilit ka kaluar, si dhe vendosjen, ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurimin e të njëjtit.

5. NJËSIA E MBROJTJES, SIGURISË DHE CILËSISË

Detyra e Njesisë së mbrojtjes, së sigurisë dhe të cilësisë është përmbushja e qëllimeve të përcaktuara vjetore, të përcaktuara në politikën e mbrojtjes/ sigurisë/ cilësisë, planit vjetor të mbrojtjes, sigurisë dhe cilësisë, si dhe në procedurën për shënjestrat dhe treguesit e sigurisë, nëpërmjet zbatimit të të gjitha proceseve nga të tre sistemet dhe nëpërmjet arritjes së një produkti ose rezultati specifik, nga secili proces që është vendosur në M-NAV dhe është pjesë e sistemeve. Me këtë qasje vërtetojmë se M-NAV-i ofron shërbime të sigurta, punon me cilësi dhe siguron në mënyrë adekuate të dhënat dhe të mirat materiale që posedon.

Vitin e ardhshëm do të shohim përditësimin e mëtejshëm të udhëzimeve dhe procedurave për mbrojtjen, cilësinë dhe sigurinë në përputhje me rregulloret e reja të BE-së.

Zhvillimi i një kulture organizative pozitive që do të garantojë SMS (Sisteme të Menaxhimit të Sigurisë) efektive dhe zbatimin e programeve të tjera më të gjera të mbrojtjes nga organizatat ndërkombëtare (ICAO, EASA, Eurocontrol, EC) si dhe rekomandime të mbrojtjes nga ANSP-të e tjera, qendrat shkollore, si dhe shoqatat profesionale dhe sindikatat.

Gjithashtu do të fokusohemi drejt bashkëpunimit rajonal nëpërmjet nënshkrimit të MU-së (Memorandum për mirëkuptim) në nivel të M-NAV-it, posaçërisht me fqinjët, ndërsa me këtë edhe shkëmbim përvojash (të dhëna jo identifikuese nga veprimet e bëra).

Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet rritjes së besimit me anë të zgjerimit të kulturës së rregullave dhe qasjes së tyre në punë, nëpërmjet zbatimit të dokumentit të ri, procedurës dhe politikës për "Just Culture" (No blame culture).

Në bashkëpunim me AAC-në, KHFAIS-në dhe Prokurorinë Publike të RMV-së parashihet që principet e "Just Culture" të bëhen pjesë e akteve normative të shtetit.

Përditësimi i të gjitha SLA-ve sipas nevojës, si dhe identifikimi i rreziqeve të reja, eliminimi ose zvogëlimi i rreziqeve. Vitin e ardhshëm do të përqendrohemi në zbatimin e një plani veprues, i nxjerrë nga kryerja e mbikëqyrjes së brendshme për kulturën e sigurisë në M-NAV.

Pjesëmarrja në kurse të specializuara të sigurisë do të vazhdojë, në mënyrë që të rritet aftësia e ekspertëve të sigurisë dhe oficerëve të sigurisë.

Detyrat kryesore të Njesisë së sigurisë

- Analiza e kulturës së sigurisë në bashkëpunim me Eurocontrol-in dhe zbatimin e vazhdueshëm të "Just Culture" (KPI-ja nr. 3).
- Zbatimi i SMS-së bazuar në performancën e matjes.
- Përfshirja dhe trajnimi i oficerëve të sigurisë, ekspertëve të cilësisë dhe ekspertëve të sigurisë në realizimin e planeve vjetore. Trajnimi i stafit të ekspertëve së bashku me udhëheqësit e projekteve për mënyrën e të

-
- vepruarit gjatë ndryshimeve të mëdha/ të vogla të parapara me rregulloren e re 373 EC e aspektit të vlerësimit të sigurisë (FHA, PSSA, Safety Case).
- Bashkëpunimi i ngushtë i M-NAV-it me KHFAIS dhe AAC nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi në përputhje me ligjin (përfshirja e Prokurorisë Publike do të jetë e dëshirueshme).
 - Zbatimi i detyrimeve të sigurisë që dalin nga projektet e EBRDS-së (BERZH) si dhe projekte të tjera që kanë ndikim te siguria – “Safety Case”.
 - Forcimi i shtyllës së tretë të sistemit të sigurisë - promovimi i sigurisë – “Safety Promotion” (përhapja e mesimit, përmirësimi i sigurisë).
 - Kompetenca e stafit do të mbikëqyret dhe përmirësohet vazhdimisht. Menaxhimi i rrezikut do të bëhet nëpërmjet sistemeve të vlerësimit dhe raportimit të sigurisë dhe të rrezikut.
 - Sistemi i ngjarjeve të sigurisë do të promovohet, stimulohet dhe motivohet vazhdimisht dhe RAT-i do të përdoret gjithmonë për të analizuar ngjarjet e sigurisë në përputhje me rregulloren (KPI nr. 2). Mjeti e-tokai pritet të zbatohet plotësisht në të gjithë sektorët operacional.
 - Eurocontrol CANSO SMS, standardet e matjes së përsosmërisë, SoE (KPI Nr. 1 për matjen e zbatimit të SMS-së) - përgatitjen, analizat dhe korrigjimin - largimin e gjetjeve, për të arritur objektivat e vendosura nëpërmjet objektivave/kërkesave të SMS, si dhe standardeve të përbashkëta të vendosura nga BE-ja nëpërmjet Eurocontrol/ CANSO ekipi i moderimit (maj-qershor 2020).
 - Analizat e trendit do të bëhen dhe do të përcaktohen objektivat e rinj të sigurisë në planet vjetore në përputhje me treguesit e rinj.
 - Vlerësimi i sigurisë do të bëhet duke identifikuar rreziqet e mundshme dhe aktuale, duke i klasifikuar ato sipas shkallës së seriozitetit, sipas mjeteve për eliminimin ose kapjen e tyre dhe formimin e një “Safety Case” për të dëshmuar se është arritur një nivel i pranueshëm i sigurisë.

Kontigjenca

Shtimi i planit të kontigjencës dhe listat e kontrollit për të gjitha aktivitetet e rëndësishme në “M-NAV”, trajnimi i stafit dhe praktikimi i ushtrimeve të rregullta në përputhje me kërkesat ligjore.

Sistemi i sigurimit (Security)

Sistemi i vendosur dhe në të njëjtën kohë mirë i zhvilluar dhe i plotë për menaxhimin e mbrojtjes, sigurisë, së bashku me sistemin e vendosur të cilësisë në M-NAV, janë një bazë e mirë për të vazhduar ruajtjen dhe përmirësimin e sigurisë së shërbimeve. Rregulloret europiane si dhe anekset e ICAO-së kërkojnë jo vetëm posedimin e një sistemi të menaxhimit të sigurisë, por të jetë i sigurt dhe efekti i tij të jetë i konsiderueshëm.

M-NAV-i është i përkushtuar në procesin e përmirësimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë, përmirësimin e tij të vazhdueshëm dhe ngritjes së nivelit të zhvillimit të sistemit të sigurisë. Në pjesën e sigurisë fizike të objekteve dhe personave,

pas përfundimit të zbatimit të sistemit të kontrollit të hyrjes dhe incizimit me kamerë në ndërtesat e KTA-së në Shkup dhe Ohër, vëmendje të veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të masave për sigurinë e pajisjeve të navigacionit të jashtëm (pajisjet në zonën tokësore).

Sa i përket sigurisë kibernetike, do të forcohet edhe sistemi për mbrojtjen proaktive ndaj sulmeve kibernetike edhe ngritja e shkallës së rezistencës ndaj rreziqeve kibernetike (security resilience). Planifikohet implementimi i mjeteve për vëzhgimin e ngjarjeve, nëpërmjet rrjetës informative, me qëllim zbulimin e veprimeve të mundshme rrezikuese, mjete për zbulimin e sulmeve dhe analiza e trafikut.

Si prioritet kryesor është ngritja e nivelit të trajnimit të punonjësve në Njësinë e sigurisë, puna e vazhdueshme për ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe kulturës së sigurisë të të gjithë punonjësve në M-NAV. Prandaj, vitin e ardhshëm ky do të jetë një nga prioritetet tona. Së bashku me Njësinë e cilësisë, është planifikuar që të fillohet procesi i zbatimit të standardit të sigurisë ISO 27001.

Motivimi i punonjësve për të raportuar ngjarjet e sigurisë është gjithashtu një nga qëllimet për vitin 2020. Rritja e aplikacioneve për vitin 2019 krahasuar me ato të mëparshme është një tregues i mirë se ky objektivi mund të arrihet.

Sistemi i cilësisë (Quality)

- Mirëmbajtja e sistemit të instaluar të cilësisë QMS në të gjithë sektorët e M-NAV-it;
- Kryerja e inspektimeve të rregullta, të brendshme, në përputhje me planin e inspektimeve;
- Mbajtja e trajnimeve informuese për të gjithë punonjësit, nëpërmjet një plani të përshtatshëm për trajnime për vitin 2019;
- Integrimi i monitorimit të sistemeve të menaxhimit;
- Instalimi i **DMS**-së dhe rregullimi i proceseve në M-NAV;
 - Arkivi
 - Burimet njerëzore
 - Furnizimet publike
 - Korrespondencat (juridike)

Koncepti **DMS** është një filozofi integruese e menaxhimit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe proceseve të M-NAV-it, është mendësia e të gjithë punonjësve se cilësia e shërbimeve të tyre duhet të jetë përgjegjësia e tyre kryesore, prioriteti i tyre, dhe gjithashtu përkushtimi i tyre që do të pranohet dhe do të ndahet në mënyrë të barabartë;

- Arritja e qëllimeve të përcaktuara të sigurisë dhe zbatimi i duhur i kërkesave për menaxhim cilësor të ndryshimeve në M-NAV;
 - Harmonizimi i proceseve në Njësinë e VI-së dhe METEO-s me rregulloret dhe kërkesat përkatëse, arritja e një niveli të lartë e cilësisë së të dhënave;
 - Zbatimi i duhur i proceseve (planifikimi, matja e rrezikut, mbikëqyrja, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit);
- Mbajtja e mbledhjeve për të menaxhuar sistemin e cilësisë;

- Sigurimi i punës në një mjedis me atmosferë produktive dhe motivimi i punonjësve
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, pajisjeve të nevojshme për kryerjen e detyrave të punës;
- Përditësimi i listës i të gjitha palëve të interesuara;
- Bërja e një ankete për të matur kënaqësinë e operatorëve;
- Sigurimi i një menaxhimi cilësor të procesit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë (ISO 9001 - ISO 14001 - ISO 45001) për t'u integruar në një sistem të përbashkët menaxhimi (IMS);
- Prezantimi i një plani evakuimi;
- Trajnime për evakuimin;
- Rishikimi i vlerësimit të rrezikut në vendet e punës;

6. NJËSIA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM

Njësia e revizionit të brendshëm organizon punën e tij në përputhje me prioritetet dhe qëllimet strategjike të shoqërisë. Misioni i revizionit të brendshëm është që t'i japë mbështetje Bordit të drejtorëve në procesin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe udhëheqjes; të sigurojë mbrojtjen e duhur të anëtarëve të BD-së dhe BM-së me sistemet ekzistuese; a janë dhe në çfarë mase ato janë efektive, efikase, ekonomike dhe në funksion të arritjes së objektivave të punës dhe masave që i propozon, të kontribuojë në përmirësimi i tyre, me të cilat "shtohet vlera" në punën e shoqërisë.

Në planin afatgjatë:

Vizioni i revizionit të brendshëm është të përmbushë plotësisht kërkesat e standardeve ndërkombëtare për kryerjen e revizionit të brendshëm dhe në mënyrë cilësore dhe me sukses ta luajë rolin e partnerit të pavarur dhe objektiv të anëtarëve të Bordit drejtues dhe Bordit mbikëqyrës: nëpërmjet këshillave dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e rreziqeve, kontrollit dhe udhëheqjes, për të ndikuar pozitivisht në punë dhe për të "shtuar vlerë" në procesin e arritjes së qëllimeve të shoqërisë.

Në Programin e tij të punës për vitin e ardhshëm, revizioni i brendshëm planifikon:

1. Kryerjen e revizioneve individuale për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm të proceseve që lidhen me marrjen e detyrimeve financiare dhe kontrollimin e shpenzimeve të fondit, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti i sistemit të kontrollit të brendshëm në:
 - proceset që lidhen me pranimin dhe evidentimin e të hyrave dhe të dalave me qëllim zvogëlimin e shpenzimeve;
 - politikat dhe procedurat për sigurimin, zhvillimin, vlerësimin dhe mirëmbajtjen e burimeve njerëzore si: shpërblimi, punësimi, mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve;
 - politikat dhe procedurat e planifikimit dhe kontrollit të buxhetit;
 - procesin e sigurimit të evidencës së saktë të kontabilitetit për evidentimin e kontabilitetit dhe raportimin financiar;
 - procesin e dhënies së shërbimeve të navigacionit ajror në Shkup dhe Ohër;

-
- procesin e sigurimit të shërbimit për mirëmbajtje (menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërhyrje) të sistemeve dhe pajisjeve;
 2. Realizim i revizioneve individuale për të vlerësuar harmonizimin e akteve të brendshme dhe funksionimin e shoqërisë me ligjet dhe standardet kombëtare dhe rregulloret europiane. Qëllimi është harmonizimi dhe zbatimi i plotë i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në procedurat dhe aktet e brendshme, të cilat tërthorazi do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve dhe kontrollin e shpenzimeve;
 3. Sigurimi i shërbimeve këshilluese në lidhje me vendosjen e proceseve për pranimin e parimeve të qeverisjes së korporatave, zhvillimin e sistemit të kontabilitetit dhe të menaxhimit informues; operimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut, të lidhur ngushtë me kërkesën për përmirësimin e strukturës organizative dhe përshtatjen e strukturave të menaxhimit me kërkesat e rregullores europiane;
 4. Realizimi i revizioneve për të ndjekur rekomandimet nga revizionet e mëparshme të realizuara me qëllim që të përmirësohet përqindja e realizimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në planet e veprimit;
 5. Realizimi i angazhimeve të revizioneve të planifikuara në planin vjetor për kryerjen e revizionit të brendshëm në tërësi;
 6. Realizimi i angazhimeve të tjera (revizione ad hoc dhe angazhime tjera shtesë) gjatë vitit me kërkesë të kryesisë;
 7. Realizimi i trajnimeve për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të punonjësve në njësi dhe certifikimin e tyre;
 8. Zhvillim i vazhdueshëm profesional, në përputhje me kërkesat e standardeve për kryerjen e revizionit.

7. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI - KEY PERFORMANCE INDICATORS)

Për të vëzhguar dhe arritur qëllimet strategjike të shoqërisë, janë përcaktuar Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI) për fushat e përcaktuara, të cilët e vlerësojnë situatën aktuale, përkatësisht përcaktojnë objektivat për periudhën tjetër.

7.1 Siguria – KPI Safety

Objektivat 2021

Qëllimi i Njesisë së mbrojtjes, sigurisë dhe cilësisë është t'i përmbushë qëllimet e përcaktuara vjetore, të përcaktuara në SBP-në dhe udhëzimet e politikës së sigurisë, si dhe në procedurën për objektivat dhe treguesit e sigurisë. Me këtë veprim ne do të dëshmojmë se M-NAV-i ofron vazhdimisht shërbime të sigurta, të rregullta dhe efikase, punon me cilësi dhe i siguron në mënyrë të duhur të dhënat dhe të mirat materiale që i posedon.

Objektivat e sigurisë:

- Objektivat e vendosura dhe përshtatja e programit të sigurisë (Ligji i Aviacionit).

- Publikimi i treguesve të sigurisë dhe analiza e arritjeve të tyre në portalin e M-NAV-it.
- Përmbushja e objektivave të përcaktuara për vitin 2021 (Lagging & Leading Targets), si rezultat i analizës së treguesve të nxjerrë për 5 vitet e fundit.

Performance Leading and Lagging Indicators	Target	Performance				Overall
		Qtr1	Qtr2	Qtr3	Qtr4	
Mandatory O Reports per 100 000 flights	25					
Mandatory T Reports per 100 000 flights	40					
Voluntary Reports/year	10					
METEO Reports/year	5					
AIS Report/ year	5					
Safety meetings/year	3					
Safety briefings/year	3					
Safety audits per year	1					
RAT analyzed occ/y (A, B, C severity) SMI;RI (AA, A, B, C severity ATM sp)	100%					
Organization-specific SPIs						
Fatal accidents per 100 000 flights	Less than 0.025					
Serious incidents per 100 000 flights (A)	Less than 0.5					
Major incidents per 100 000 flights (B)	Less than 2					
Significant incidents per 100 000 flights (C)	Less than 5					
SMI /100 000 flights	6					
Airspace infringement/ per 100 000 flights	2					
Bird strike per 10000 flights	Less than 5					
Runway incursion per 4000 flights	Less than 2					

Runway excursion per 4000 flights	Less than 0.5					
Serious CIFT per 10 000 flights	Less than 0.5					
Laser strikes per 10 000 flights	Less than 0.5					

EU Reg.390 Performance measurement for Safety Management (CANSO/Eurocont/SoE)	Level C	Just Culture; Fatigue management; Emergency response plan International regulations	
	Level D	All others 29 leading SM Targets	

<u>Availability of SUR</u> SLA CBH-CBT MHB-750-300-PY-002	Overall annually MSSR En-route 99,90% MSSR TMA 99,50% PSR 99,50%					
<u>Availability of COM</u> SLA CBH-CBT MHB-750-300-PY-002	Overall annually A/G & G/G 99,95% COM Data Proc 99,90%					
<u>Availability of NAV</u> SLA CBH-CBT MHB-750-300-PY-002	Overall annually					

	<table border="1"> <tr> <td>ILS</td> <td>>99,0 %</td> </tr> <tr> <td>VOR/DME</td> <td>>98,0 %</td> </tr> <tr> <td>NDB</td> <td>>98,0 %</td> </tr> </table>	ILS	>99,0 %	VOR/DME	>98,0 %	NDB	>98,0 %					
ILS	>99,0 %											
VOR/DME	>98,0 %											
NDB	>98,0 %											

7.2 Siguria - KPI Security

Pandemia KOVID-19 që goditi botën, gjithashtu pati një ndikim në arritjen e qëllimeve dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2020. Pavarësisht nga zvogëlimi i konsiderueshëm i trafikut, mosarritja për të zbuluar pjesën më të madhe të implementimeve të planifikuara që kanë për qëllim forcimin e sistemit të sigurisë, qëllimet u arritën. Bazuar në parashikimet për kthimin e shpejtë të situatës në normalitet, qëllimet për vitin 2021 nuk ndryshojnë.

Objektivat e vendosura përpara sistemit, të cilat janë në përputhje me Programin e sigurisë, që është në përputhje me Programin e sigurisë kombëtare, janë këto:

- Jo më shumë se 1 (një) çrregullim, që do të shkaktojë dëm material më të madh se 62,000 denarë;
- Të mos ketë çrregullim të sigurisë me shkallë shumë të lartë (1) dhe të lartë (2) të seriozitetit;
- Jo më shumë se 1 (një) çrregullim me shkallë të mesme të seriozitetit (3);
- Jo më shumë se 10 (dhjetë) çrregullime me lartësi të çrregullimit (4);

Arritja e qëllimeve nënkupton aktivitete të përditshme me synim për realizimin e tyre.

7.3 Efikasiteti i fluturimeve - KPI Flight efficiency

OBJEKTIVI 2021

Arritja e KPI-së që i referohet efikasitetit horizontal të fluturimit (tregon ndryshimin mesatar midis trajektorës së realizuar dhe distancës më të shkurtër ndërmjet dy pikave) me një vlerë <2.47% për vitin 2021.

1.4 Kapaciteti i shërbimeve të dhëna të kontrollit të trafikut ajror (i treguar përmes vonesave të fluturimeve) - KPI Capacity (Delays)

OBJEKTIVI 2021

Në vitin 2021, të sigurohet një vonesë mesatare gjatë operacioneve en-route (fluturime) deri në 0.9 min/ fluturim.

Objektivat referuese finale për vonesat për periudhën 2021-2025 do të jenë të mjaftueshme, pas miratimit të vendimit final nga ana e Komisionit European.

Kapaciteti i tanishëm në fushën e kontrollit të trafikut ajror, në Shkup është i mjaftueshëm për t'i përmbushur kërkesat e itinerareve të tanishme, veçanërisht, shikuar situatën me Kovid-19 dhe kërkesat e zvogëluara. Përderisa është i nevojshëm në varësi të rritjes së kërkesës, i njëjti do të rritet.

1.5 Efikasiteti i shpenzimeve - KPI Cost-efficiency

Një tregues kryesor i efikasitetit të shpenzimeve është çmimi i vetëm për fluturim, d.m.th. kostoja e vetme për njësinë e caktuar të shërbimit në një nivel real (indeksi i çmimit - baza 100 në vitin 2009), për të mundësuar krahasimin me nivelin e performancës (performance) së arritur në periudhën e mëparshme.

Sipas Vendimit për zbatimin e Komisionit European (EU) 2019/903 datë 29.5.2019 qëllimet për arritjen e efikasitetit të shpenzimeve në nivelin e BE-së duhet të mundësojnë uljen e njësisë së shpenzimeve fikse sipas njësisë së shërbimit të dhënë me 1.9% në vit, gjatë periudhës së tretë referuese të viteve 2020-2024.

Për shkak të situatës me pandeminë Kovid-19, në këtë moment është iniciuar një proces i ndryshimeve me të cilat do të rishikohen objektivat për efektivitetin e shpenzimeve për vitin 2020 dhe 2021. Në përputhje me këto ndryshime, objektivat e rishikuara për efektivitetin e shpenzimeve për periudhën e tretë referuese do të përcaktohen pas vendimit përfundimtar të Komisionit European.